



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenet 15, 24 dhe 64, në bazë të Rregullës Zgjedhore Nr.8/2013 për Certifikimin i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre, si dhe në përputhje të plotë me Vendimin nr 928-2020 për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në dhe Vendimi nr. 932-2020 për miratimin e planit operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Mitrovicën e Veriut, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 10.11.2020, nxjerr këtë:

Udhëzues

Për Shortin për Renditje të Subjekteve Politike të Certifikuara në Fletëvotimin për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Mitrovicës së Veriut që do mbahen me 29 nëntor 2020

- I. Ky udhëzues ka për qëllim të përcaktoj procedurat që duhen respektuar gjatë tërheqjes së shortit për renditjen e subjekteve politike në Fletëvotimin për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Mitrovicës së Veriut që do të mbahen me 29 nëntor 2020, si në vijim;
 - a. Shorti i renditjes së subjekteve politike të certifikuar në fletëvotim mbahet më 12 nëntor 2020, në ora 10:00.
 - b. Kryetarja e KQZ-së, kryeson procesin e tërheqjes së shortit dhe siguron që tërheqja e shortit është e drejtë dhe transparente.
 - c. Zëdhënësi i KQZ-së moderon ceremoninë e tërheqjes së shortit për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim.
 - d. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, i njofton subjektet politike të certifikuar për vendndodhjen, datën dhe kohën, në të cilën shorti i renditjes në fletëvotim do të mbahet.
 - e. Secili subjekt politik i certifikuar, dërgon nga një përfaqësues për të tërhequr shortin dhe vëzhguar mbajtjen e shortit të fletëvotimit.
 - f. Nëse subjekti politik, nuk e dërgon përfaqësuesin në shortin e fletëvotimit, një anëtar i përzgjedhur nga Sekretariati i KQZ-së e tërheq shortin për atë subjekt politik.

- g. Emrat e subjekteve politike të certifikuara për të marrë pjesë në zgjedhje, të futura në topa të mbyllur, do të vendosën në një vazo të veçantë.
 - h. Numrat nga numri 121 deri në numrin 124 janë të shtypur në letër, të futur në katër topa identik, të mbyllur dhe të vendosur në një vazo;
 - i. Zyrtari i Sekretariatit do të tërheqë topat me emrat e subjekteve politike të certifikuara dhe kështu cakton radhën e përfaqësuesve të subjekteve politike të certifikuara për të tërhequr numrin e vet në fletëvotim.
 - j. Përfaqësuesi i autorizuar i subjektit politik tërheqë nga vazo topin me një numër rendor në të. Numri i tërhequr do të jetë numri e atij subjekti politik në fletëvotim.
- II. Obligohet Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim për zbatimin e këtij vendimi;
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

